

VENDIM
Nr.275, datë 18.3.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
KOMUNËS MOLLAS, TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Mollas të qarkut të Elbasanit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 79 (shtatëdhjetë e nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 529 (pesëqind e njëzet e nëntë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Mollas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Mollas

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-5	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
6	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
7	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
9-13,448-464,465-529	Troje të lira ose hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekte e të çdo lloji.	Në përdorim
14-39	Varrezat publike	Në pronësi
40-46	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
154-248,330-418	Infrastrukturë (rrugë vendore, hapësirë publike).	Në pronësi
304	Prona që përdoren në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
111,117,118,119,125-127,132,133,134,139-141,146,147,152,153,250,257,258,273	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi
106-109,112-115,120,122-124,128-130,135-138,142-144,148-150	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim